



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 282, datë 19.12.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TRANSFERIMIT TË PERSONELIT
ADMINISTRATIV TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

Në mbështetje të nenit 159, të Ligjit Nr. 115/ 2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 113, i Ligjit nr.97/2016” Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, miraton rregullat si më poshtë :

NENI 1

QËLLIMI DHE OBJEKTI

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme që kryhen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbi procedurat e transferimit të të punësuarve aktual në prokurorinë pranë gjykatës shkallës parë për krime të rënda dhe prokurorinë pranë gjykatës së apelit për krimet e rënda, në funksion të krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore.

Ky vendim përcakton rregulla lidhur me procedurat që Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvillon për transferimin e personelit administrative të prokurorive të krimeve të rënda si dhe evidentimin e të dhënave të këtij personeli që aktualisht janë në marrëdhënie pune në këto prokurori.

Për efekt të kësaj rregulloreje;

- **Ristrukturim**, do të konsiderohet: Ndryshim thelbësor i brendshëm i Institucionit, proces riorganizimi, për arsye se:
 - ka pasur ndryshime të misionit të institucionit;
 - janë shtuar apo pakësuar vende pune dhe funksionet e institucionit;
 - kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës;
 - kërkohet një rishpërndarje e ndryshme e burimeve të shtuara apo pakësuara për kryerjen e funksioneve.
- **Transferim** – Transferimi apo lëvizja (zhvendosja) e përhershme e personelit administrativ nga një pozicion në një tjetër pozicion pune brenda së njëjtës kategori në sistemin e prokurorisë.

- **Mbyllje-** Përfundimi i funksionimit të institucionit të Prokurorive të krimeve të Rënda.

NENI 2

SUBJEKTET QË I NËNSHTROHEN TRANSFERIMIT

Subjektet që i nënshtrohen transferimit sipas kësaj rregulloreje janë:

- 1) Personeli administrativ i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- 2) Personeli administrativ i Prokurorisë pranë gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

NENI 3

KUADRI LIGJOR PËR TRANSFERIMIN E PËRSONELIT

ADMINISTRATIV TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

Këto rregulla zbatohet në përputhje me:

- 1) Ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.e Shqipërisë".
- 2) Ligjin nr.95/2016 , "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"
- 3) Ligjin n.r.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"
- 4) Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civilë", i ndryshuar
- 5) Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i R. së Shqipërisë"
- 6) Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës në R. e Shqipërisë"
- 7) Akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim.

NENI 4

RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT

PËR PERSONELIN ADMINISTRATIV TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

- a) Këshilli i Lartë i Prokurorisë ngre Komisionin e Ristrukturimit, i cili drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në të bëjnë pjesë drejtuesit dhe kancelarët e prokurorive që i nënshtrohen procedurës së riorganizimit.
- b) Komisioni i restrukturimit ngrihet me urdhër të Kryetarit të KLP-së.

- c) NËpunësit civilë dhe punonjësit në detyrë në Prokurorinë e Shkallës së Parë dhe Prokurorinë e Apelit të Krimeve të Rënda konsiderohen nëpunës civilë dhe punonjës të Prokurorisë së Posaçme, nëse plotësojnë kushtet e sigurisë, të caktuara me ligj të veçantë.
- d) Në rastet kur i punësuari ose nëpunësi civil në detyrë nuk përmbush kushtet e sigurisë, punonjësi në detyrë mund të transferohet si nëpunës civil në një pozicion të lirë në një tjetër prokurori, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara me këtë ligj”.

NENI 5

KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT, TRANSFERIMIT TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

Komisioni i Ristrukturimit për transferimin e personelit administrativ, do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë,

- ✓ **Kryetar**, *Përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. (1 anëtar)*
- ✓ **Anëtarë**, *Drejtuesit e Prokurorive që do të ristrukturohen. (2 anëtarë)*
- ✓ **Anëtarë** *Kancelarët e Prokurorive që do të ristrukturohen. (2 anëtarë)*

Komisioni i Ristrukturimit i propozon Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në të cilën punonjësi administrativ mund të transferohet, fillimin e shqyrtimit administrativ për mundësinë e sistemit të çdo personeli administrativ të prokurorive të krimeve të rënda.

Kancelarët e prokurorive të krimeve të rënda, kanë për detyrë t'i paraqesin Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës administrativ në prokuroritë e krimeve të rënda që i nënshtrohet procesit të transferimit, që përfshin:

- a) Përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara, si dhe ndryshimin e kriterëve specifike;
- b) Dosjen personale të nëpunësve administrativ në pritje për transferim;
- c) Vërtetimin e vendbanimit të nëpunësit administrativ, të certifikuar nga organet kompetente.

Kancelarët nëse kanë dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas Ligjit për Qeverisjen, janë të detyruar të zbatojnë rregullat në lidhje me konfliktin e interesit apo pengesën ligjore.

NENI 6

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT PËR TRANSFERIMIN E PERSONELIT ADMINISTRATIV TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

Në funksion të procesit të ristrukturimit, Komisioni i ristrukturimit, mban parasysh sa më poshtë:

1. Komisioni i Ristrukturimit i propozon Drejtuesit të Prokurorisë Posaçme marrjen e vendimit të transferimit të personelit administrativ të prokurorive të krimeve të rënda.
2. Drejtuesi i prokurorisë, në të cilën nëpunësi transferohet është kompetent për dhënien e vendimit të transferimit të personelit administrativ.
Procesi i ristrukturimit dhe transferimit të personelit administrativ përfundon pas miratimit të strukturës dhe organikës së prokurorisë së ristrukturuar apo krijuar rishtazi.
3. Të njoftojë kandidatin për fillimin e procedurës së transferimit me shkresë, ose në adresën elektronike.
4. Komisioni i ristrukturimit për transferimin e personelit administrativ për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në të dhënat e dosjes personale të punonjësve administrativ, pozicionet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit.

NENI 7

KRITERET E TRANSFERIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV TË PROKURORIVE TË KRIMEVE TË RËNDA

Nisur nga parimi që transferimi do të kryhet brenda të njëjtës kategori, përshtatshmëria me vendin e punës do të jetë sipas kërkesave të vendit të punës, dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh për efekt transferimi, janë :

- Arsimimi dhe kualifikimi në punë;
- Vjetërsia në punë dhe në profesion;
- Vlerësimet e rezultateve në punë.

NENI 8

PËRFUNDIMI I DETYRËS SË KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT

Për secilin nga pozicionet e punës të krijuar si rezultat i ristrukturimit të prokurorisë mbi bazën e kriterëve, komisioni do të marrë në shqyrtim për të vlerësuar për transferim në këto pozicione, vetëm punonjësit administrativ që plotësojnë kriteret e pozicionit të punës në të cilin mendohet të transferohet.

Komisioni, pas administrimit të dosjeve të personelit administrativ, ia përcjell ato Prokurorisë së Posaçme si autoriteti kompetent, që vazhdon procedurat sipas pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.95/2016.

NENI 9

HYRJA NE FUQI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe publikohet në faqen zyrtare të KLP.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI